



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

Sqarim mbi disa të dhëna të publikuara nga media

lidhur me vendimet e fundit të Autoritetit të Konkurrencës

Autoriteti i Konkurrencës vlerëson rolin e medias në informimin e publikut dhe kontribuon gjithmonë me transparencë në çështjet që lidhen me funksionimin e tregjeve dhe mbrojtjen e konkurrencës së ndershme. Në vijim të disa publikimeve të fundit mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës **në tregun e grumbullimit të frutave dhe perimeve**, dëshirojmë të saktësojmë disa elementë të rëndësishëm të faktit dhe të procedurës.

1. Objekti i hetimit të thelluar përfunduar më 26.11.2025

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e datës 26.11.2025, miratoi vendimet nr. 1234–1239, me të cilat konstatoi se një grup ndërmarrjesh **grumbulluese** – Omer Fruit SHPK, Nedrete Arapi PF, Besim Thaqi PF, Morina Grup SHPK, Fruit-To-Zela SHPK dhe Roland-2012 SHPK – kishin bashkërenduar sjelljen gjatë periudhave të sezonit, duke diktuar çmimet në dëm të fermerëve prodhues dhe duke aplikuar marzh fitimi (mark-up) të lartë, deri në 115%.

Objekt i këtij hetimi, i nxitur kryesisht nga ankimet e fermerëve lokalë, ishte **“grumbullimi dhe shitja me shumicë e fruta perimeve”** dhe subjekte të këtij hetimi rrjedhimisht ishin **ndërmarrjet që ushtronin veprimtari grumbulluese dhe shitëse**.

2. Pse ndërmarrja EKMA Albania SHPK nuk ishte subjekti i këtij hetimi

Ndërmarrja EKMA Albania SHPK nuk ushtron aktivitet grumbullimi të produkteve bujqësore, por operon në **tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve agro-ushqimore** në Tiranë. Për këtë arsye, subjekti nuk bën pjesë në tregun përkatës që ishte objekt i hetimit të përfunduar në nëntor 2025.

Megjithatë, kjo nuk e ka penguar Autoritetin e Konkurrencës që, në të shkuarën, të ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore ndaj çdo subjekti, përfshirë EKMA Albania SHPK, sa herë që janë konstatuar shkelje në tregun ku ky subjekt operon. Nuk e pengon as për hapjen e një hetimi të ri, në të ardhmen.

3. Mbi vjelen e gjobës ndaj EKMA Albania SHPK

Në lidhje me pretendimin për ekzekutimin e *vetëm një pjese të vogël të gjobës* së vendosur ndaj EKMA Albania sh.p.k., për korrektesë dhe transparencë, sqarojmë sa vijon:

– Me Vendimin nr.572, datë 22.11.2018, Komisioni i Konkurrencës vendosi gjobë ndaj EKMA Albania SHPK për abuzim me pozitën dominuese në **tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve agro-ushqimore** në Tiranë.

- Vlera e gjobës ishte **43,168,617 lekë** dhe është **ekzekutuar 100%** duke kaluar në favor të buxhetit të shtetit.

Ky element është i rëndësishëm për të theksuar se zbatimi i vendimeve të Autoritetit të Konkurrencës është i plotë dhe nuk ka asnjë rast të papërmbyllur nga ana e institucioneve përgjegjëse.

Autoriteti i Konkurrencës mbetet i angazhuar të garantojë konkurrencë të ndershme dhe funksionimin efikas të tregjeve.